



Planuar / Doretuar Primjen / Prodato Received / Delivery	26.08.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSITOK	4995/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.660/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.660/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatin

Komuna e Podujevës, kundër Vendimit Nr.02-112/02-0060477/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.08.2022, mori këtë :

### V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.660/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. *Shfuqizohet* Vendimi Nr.02-112/02-0060477/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës.
- III. *Obligohet* Kryetari i Komunës së Podujevës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë(15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të kthej ankuesin në pozitën *Inspektor Tregu* sipas Akt-it të Emërimit të datës 01.08.2020, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. ~~Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.~~

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës, më datë 26.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4308/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.02-112/02-0060477/22 të datës 22.07.2022

të Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, me bazë ankimore që i njëjti të anulohet si i paligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.07.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, më datë 28.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e me numër protokoll 4308/2022 të datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 01.08.2020 të ankuesit; Vendimin Nr.02-112/02-0060477/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës; Emailin e datës 26.07.2022 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 28.07.2022; Kërkesën për transfer e datës 20.07.2022; Pëlqimin për transfer i datës 22.07.2022; Përshkrimin i detyrave të punës për Inspektor i Tregut dhe Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve; Diplomën me Nr.222/10 e datës 05.08.2010 për ankuesin; Diplomën me Nr. 1641/20 të datës 06.10.2020 për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi sipas Akt-it të Emërimit të datës 01.08.2020 është emëruar dhe i njëjti ka ushtruar pozitën "Inspektor i Tregut" në Komunën e Podujevës. Me datë 20.07.2022 Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, për transferimin e një zyrtari në Drejtorinë e tij për shkak të nevojës për zyrtarë profesional në këtë drejtori, ndërsa Drejtori i Inspeksionit më datë 21.07.2022 ka dhënë pëlqimin për transferim ku ka propozuar ankuesin si zyrtar të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të punës që lidhen me fushën ekonomike. Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 22.07.2022 ka nxjerr Vendimin Nr.02-112/02-0060477/22 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Inspektor i Tregut në pozitën Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke shtuar së ky vendim është marrë nga personi jo kompetent, nuk është përcaktuar kohëzgjatja e transferimit, dhe se nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor mbi bazën e jo kompetencës, Kolegji ju referua nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë me

të cilin është përcaktuar se: *Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë nga personi jo kompetent përkatësisht në rastin kontestues vendimin për transferimin e përkohshëm të ankuesit e ka lëshuar Kryetari i Komunës së Podujevës e jo Menaxherja e Njësisë së Burimeve Njerëzore si organ kompetent, andaj, mbi këtë bazë konstatimi rrjedhë së është i bazuar pretendimi ankimor theksuar si me lartë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, ka analizuar nenin 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin shprehimisht përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve...*, ndërsa nga vlerësimi i Vendimit Nr.02-112/02-0060477/22 të datës 22.07.2022 për transferim të përkohshëm të ankuesit, Kolegji gjen se në vendimin në fjalë nuk është saktësuar kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm, kështu që mbi këto arsye e në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi ankimor se Vendimit Nr.02-112/02-0060477/22 i datës 22.07.2022 për transferim të përkohshëm të ankuesit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitën e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Për me tepër, Kolegji nga analizimi i provave materiale lidhur me këtë çështje ankimore gjen se arsye e transferimit të përkohshëm të ankuesit nga pozita e Inspektorit të Tregut në pozitën Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve, ka qenë mungesa gjegjësisht nevoja e stafit profesional në Drejtorin për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, ndërsa sipas shkresës së datës 21.07.2022 të Drejtorit të Inspeksionit rezulton se kemi edhe kërkesë për transferim të zyrtarit për regjistrim të bizneseve nga Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik në Drejtorinë e Inspeksionit, fakt ky që shpërfaq rrethana kundërthënëse në mes të kërkesës për transferim të datës 20.07.2022 si dhe vet vendimit për transferimin e përkohshëm të ankuesit.

Sa i përket pretendimit ankimor se vendimi i kontestuar nuk përmban elementet e aktit administrativ siç kërkohet më nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji nga analizimi i vendimit të kundërshtuar konstatoi se i njëjti përmban vetëm pjesën hyrëse dhe dispozitivin, ndërsa nuk përmban pjesën arsyetuese dhe këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku shprehimisht është theksuar se: 1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të

aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”, kështu që pretendimi i ankuesit mbi këtë bazë ankimore është ligjërisht i drejtë dhe i bazuar.

Nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së një akt administrativ i nxjerr nga organi jo kompetent, me shkelje të dispozitave materiale si dhe duke mos respektuar elementet e detyrueshme të aktit administrativ është akt administrativ i paligjshëm ashtu siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e në këtë kuptim dhe më qëllim të vendosjes së ligjshmërisë Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.660/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**  
Kryetare e Kolegjit



#### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

